

PROCESVERBAL

nga mbledhja e tetë e Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe bashkësive tjera nacionale.

Mbledhja e Komisionit u mbajt me 27 tetor 2022

Në mbledhje morën pjesë:

1. Admir Adroviq, kryetar;
2. Frashër Selimaj, anëtar;
3. Tripo Matijeviq, anëtar;
4. Ivana Krushçiq, anëtare;

Veron Halili, anëtar dhe Mirheta Garçeviq, anëtare, nuk mori pjesë në mbledhje për shkaqe të obligimeve të mëparshme, për ç'gjë e njoftoi kryetarin e Komisionit.

Krahas anëtarëve të Komisionit, në mbledhje mori pjesë edhe Ivan Lekoviq, sekretar i Komisionit.

Në mbledhje u miratua

RENDI I DITËS

1. Diskutimi dhe deklarimi për Procesverbalin nga mbledhja e shtatë e rregullt e Komisionit.;
2. Diskutimi dhe deklarimi për propozimin e Planit programor dhe të Produksionit të RTMZ për vitin 2023;
3. Diskutimi dhe deklarimi për propozimin për emisionin e ri për trashëgiminë kulturore të popujve pakicë;
4. Diskutimi dhe deklarimi për propozimin e vizitave studimore të RTV në rajon;
5. Diskutimi dhe deklarimi për shtimin e kompensimeve për anëtarët e Komisionit;
6. Të ndryshme.

I

Procesverbali nga mbledhja e shtatë e rregullt e Komisionit u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm.(4 vota PËR).

II

Admir Adroviq e lexoi një pjesë të propozimit për Planin programor dhe të Produksionit të RTMZ që ka të bëjë me emisionet për popujt pakicë dhe bashkësitë tjera.

Radio i Malit të Zi

Frashër Selimaj theksoi se është propozim i tij që të futet emetimi i lajmeve shkurt në gjuhën shqipe, çdo ditë në ora 14.

Tripo Matijeвиќ konsideron se lajmet e mëngjesit në gjuhën shqipe duhet të emetohen edhe në muajt e verës, kështu që në vend të 216 të planifikuara, duhet të jetë 260 emisione të emetuara. Ngjashëm është propozimi edhe për emisionin “Spona”, i cili në vend të 40 emisioneve të planifikuara, për shkak të pauzës verore, do të duhej të ketë 44 emisione. Gjithashtu theksoi se në muajt e verës ka mjaft përmbajtje, manifestime, festivale që të mund të sigurohet material i mjaftueshëm për realizimin e emisionit të cekur.

Televizioni i Malit të Zi

Frashër Selimaj cekur se nuk ka vërejtje në tekstin e propozuar.

Tripo Matijeвиќ konsideron se teksti i propozuar është mjaft i thjeshtë, në aspektin e mungesës në tabela, ku mungojnë përshkrimet, komentet, terminet e emetimeve. Tabelat të cilat i ka dorëzuar RMZ kanë shumë më përmbajtje dhe konsideron se në të ardhmen do të duhej të unifikohen. Gjithashtu, kur bëhet fjalë për emisionin, “Mostovi”, kohëzgjatja e tij nga e propozuar prej 30 minutash, për ç’gjë është biseduar edhe në mbledhjet e mëparshme. Krahas kësaj, në tekstin e propozuar është theksuar se skema verore fillon nga 26 janari, në vend të qershorit.

Ivana Krushçiq theksoi se do të duhej të sqarohen detajet rreth emisionit, “XY” dhe “Glasovi iz susjedstva”.

III

Admir Adroviќ theksoi se në mbledhjen e kaluar është hapur diskutimi për propozimi e emisionit të ri, që do të mërej me trashëgiminë kulturore të popujve pakicë.

Tripo Matijeвиќ theksoi se emisioni do të duhej të jetë të formës së kolazhit të hapur me raporte kulturore, tradicionale, manifestimet. Në veçanti cekur, “Karnevalet e Kotorit” dhe “Ditët e letërsisë”, nga qytetet e ndryshme. Gjithashtu cekur projektet nga Qendra për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës së pakicave dhe Fondit për pakica, të cilat ndajnë mjete të mëdha, e nuk janë edhe aq të përcjellura në media. Ai propozon se emisioni duhet të pasurohet me intervista, raporte për objektet fetare dhe me gjera tjera interesante. Kohëzgjatjen e tij do t’ia linte menaxhmentit, redaktorëve, që ta caktojnë, e gjithsesi jo më pak se 30 minuta, me një emision në dy javë.

Admir Adroviќ e përkrahu propozimin dhe konsideron se do të kishte material që emisioni të emetohet edhe një herë në ditë. Emërimi punues i emisionit, sipas propozimit të Tripo Matijeвиќ do të ishte, “Trashëgimia kulturore e pakicave në Mal të Zi”.

IV

Tripo Matijević theksoi se propozimi për vizita ishte miratuar nga përbërja e kaluar e Këshillit të RTMZ, por për shkak të “Kovidit” nuk është realizuar. Propozimi nënkupton dy vizita të ndara. E para kishte të bënte me vizitat e shtëpive televizive në Serbi, Vojvodinë e Kosovë. Posaçërisht theksoi RTV e Kosovës, për të cilin është i informuar se ka program shumë të zhvilluar të pakicave, duke përfshirë këtu kanalën e veçantë kushtuar tyre. Vizita e dytë kishte të bënte me Kroacinë dhe Bosnjë Hercegovinën. Parashihet që në vizitat e cekura të jenë anëtarët e Komisionit dhe të punësuarit në RTMZ, në programin për pakica. Mjetet për vizitë do të siguroheshin nga RTMZ, e kjo do të nënkuptonte transportin, fjetjen dhe mëditjet për anëtarët e Komisionit dhe të punësuarit. Në rast se RTMZ nuk mund të sigurojë të gjitha mjetet, atëherë do të kërkohej mënyra e bashkëfinancimit me Këshillat nacional ose sponsor të tjerë.

V

Admir Adroviq në emër të të gjithë anëtarëve theksoi se Komisioni i është drejtuar Këshillit të RTMZ për këtë rast dhe se përgjigja e tyre është se duhet pritur një kohë të caktuar që të mund të shihet mënyra dhe kualiteti i punës së Komisionit. Duke pasur parasysh se janë mbajtur tetë mbledhje, nga të cilat janë drejtuar iniciativa të ndryshme për Këshillin e RTMZ, në bazë të të cilave mund të shihen të cekurat, konsideron se është koha që tu drejtohen përsëri.

VI

Në kuadër të pikës, Të ndryshme, nuk kishte tema për diskutim.

PROCESVERBALIN E PUNOJ
Ivan Leković

KRYETARI I KOMISIONIT
Admir Adroviq